

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.**

KOMPANIA E UJËSJELLËSIT RAJONAL
HIDRODRINI

Nr. 46 SH.A. PEJË
Data 10.02.2020

HIDRODRINI

Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Bazuar në 34 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-087 për NP, neni 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-042 për Shërbimet e ujit, KRU "Hidrodrini" Sh.A.Pejë me qëllim të harmonizimit të shprehjeve të caktuara të përdorura në aktet nënligjore të KRU "Hidrodrini" Sh.A.Pejë, Bordi i Drejtorëve nxjerrë:

**RREGULLORE NR.06/2019 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES NR.01/2017 , RREGULLORES NR.03/2017, RREGULLORES
NR.04/2017 DHE RREGULLORES NR.05/2017**

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim harmonizimin e shprehjeve të caktuara të përdorura në aktet nënligjore të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e ujit dhe Ofruesve të shërbimeve të ujit .

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për aktet nënligjore, si në vijim :

1. Rregulloren Nr.01/2017 për zgjedhjen e ankesave të konsumatorëve
2. Rregulloren Nr.03/2017 për procedurat e ndërprerjes së Shërbimeve të ujit
3. Rregulloren Nr.04/2017 për Procedurat e Faturimit të Shërbimeve të ujit
4. Rregulloren Nr.05/2017 për matjen e Konsumit të Ujit

Neni 3
Ndryshimi dhe plotësimi i akteve nënligjore të KRU " Hidrodrini" Sh.A.Pejë

Shprehjet e përdorura në aktet nënligjore të cekura në nenin 2 të kësaj Rregullore riformulohen me tekstin në vijim:

1. Zona e shërbimit – zona e shërbimit e cila është përcaktuar me aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria e Kosovës.

- 2. Ofrues i shërbimeve** - çdo person juridik i regjistruar që ka aktivitet primar ofrimin e shërbimeve të ujit.
- 3. Faturë** – dokumenti i cili dërgohet te konsumatori nga ofruesi i shërbimeve për të paguar detyrimet për shërbimet e ofruara.
- 4. Komisioni Këshillues i Konsumatorëve** - secilën herë që përmendet në aktet nënligjore të KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Pejë “**Komisioni Këshillues i Konsumatorëve**“ zëvendësohet me tekstin në vijim: “**Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve**” i cili është themeluar dhe vepron në kuadër të Autoritetit.
- 5. Ujëmatës** - çdo aparat apo pajisje i cili përdoret nga ofruesi i shërbimeve për të matur sasinë e ujit të përpunuar dhe konsumuar.

Neni 4
Dispozitat kalimtare

Me këtë Rregullore bëhet ndryshim plotësimi i Rregulloreve përkatëse për të harmonizuar shprehjet e përdorura në këtë Rregullore

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi 7 ditë pas aprovimit nga autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në webfaqen e KRU “Hidrodrini” Sh.A.Pejë

Pejë më dt. 31.01.2020



Kryesues i Bordit të Drejtorëve
z. Demë Abazi